



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare*

UDHËZUESI NUMËR 16

**SANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE PËR FËMIJËT
VIKTIMA TË KRIMEVE SEKSUALE**

STANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE PËR FËMIJËT VIKTIMA TË KRIMEVE SEKSUALE

QËLLIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE PËR FËMIJËT VIKTIMA TË KRIMEVE SEKSUALE

Qëllimi i shërbimeve sociale për fëmijët viktimë të krimeve seksuale është sigurimi i rehabilitimit social-psikologjik dhe reintegrimit të fëmijëve si dhe sigurimi i mbështetjes për anëtarët e familjeve të tyre dhe ruajtjen e mirëqenien e tyre.

GRUPET PRIORITARE

Grupet prioritare:

- Çdo fëmijë viktimë e krimit seksual (siç përcaktohet në legjislacionin përkatës kombëtar)
- Çdo fëmijë në rreziku prej çfarëdo lloji të krimit seksual

PARIMET KRYESORE

- Prioriteti absolut i interesave më të mira të fëmijës
- Ndërtimi i besimit
- Konfidencialiteti
- Ofrimi i shërbimit pa diskriminim gjinor, etnik ose religjioz

AKTIVITETET KRYESORE PËR SHËRBIMET SOCIALE PËR FËMIJËT VIKTIMA TË KRIMIT SEKSUAL

Aktivitetet vijuese që do të zhvillohen:

- Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave
- Sigurimi i informatave
- Sigurimi i mbështetjes sociale
- Sigurimi i mbështetjes psikologjike
- Sigurimi i kujdesit shëndetësor
- Sigurimi i mbështetjes edukativo-arsimore

STANDARDET MINIMALE

Standardet minimale strukturale	Indikatorët e performancës
X.1.1 Shërbimet socio-psikologjike për fëmijët viktimë të abuzimit seksual do të sigurohen nga ofruesit e shërbimeve sociale punëtorë të licencuar dhe psikologë të licencuar.	<ul style="list-style-type: none">• Licencat valide të specialistëve;

X.1.2 Ofruesit e shërbimeve sociale do të trajnohen në mënyrë specifike për të ofruar shërbime për fëmijët viktime të krimeve seksuale.	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi të trajnimeve tematike
X.1.3 Çdo ofrues i shërbimeve sociale dhe psikolog që do të punojë me fëmijët viktime të krimit seksual do të ketë jo më tepër se 4 raste aktive (çdo lloj i rastit aktiv)	<ul style="list-style-type: none"> • ofruesi i shërbimeve sociale / raste të hapura; • Psikologë/ raste të hapura
X.1.4 Konsultimi dhe trajtimi socio-psikologjik do të zhvillohen në hapësirë të përshtatshme dhe të rehatshme për fëmijë.	Zyre të mobiluara në mënyrë adekuate
X.1.5 Strehimoret/ institucionet rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët viktime të krimit seksual do të plotësojnë kërkesat e standardeve minimale strukturale të përcaktuara për institucionet rezidenciale/ strehimoret.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi në raportet e monitorimit • Licenca Valide
Standardet funksionale	Indikatorët e performancës
X.2.1 Të gjitha veprimet e ofruesit të shërbimit do të bazohen në interesat më të mira të fëmijës dhe do të synojnë mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme. • Njohuri mbi legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor për të drejtat e fëmijës.
X.2.2 Ofruesi i shërbimit do të sigurojë Konfidencialiteti e detajeve të rastit. Informatat konfidenciale do të ndahen vetëm për trupat e autorizuar me aprovimin e prindërve ose përfaqësuesve ligjor të tij/saj dhe pas marrjes së mendimit të fëmijut të moshës mbi 10 vjeçare siç kërkohet me legjislacionin vendor	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësim në raportet e monitorimit
X.2. 3 Ofruesi i shërbimit social do të informojë fëmijën rreth objektivave dhe mënyrave të intervenimit profesional si dhe rolin e profesionisteve të cilët do të punojnë me fëmijën. Informatat do të ofrohen duke marrë parasysh kushtet psikologjike, shëndetësore, moshën, gjininë dhe religjionin e fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullore të brendshme • Profesionist të trajnuar
X.2.4 Ofruesi i shërbimit social do të sigurojë informata adekuate për prindërit /kujdestarin e fëmijës rreth objektivave dhe mënyrave të intervenimit profesional si dhe rolin e profesionisteve të cilët do të punojnë me fëmijën dhe anëtarët e familjes. Në raste kur prindi/ërit ose anëtari i familjes dyshohet për krim seksual ndaj fëmijës, ofruesit e shërbimit social do të informojnë të dyshuarin rreth veprimeve të cilat do t'i ndërmarrin për të siguruar mbrojtjen psikologjike dhe fizike të fëmijës dhe anëtarëve tjerë të familjes si dhe veprimet në lidhje me thirrjen për llogaridhënie ligjore të të dyshuarit.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme
X.2.5 Bazuar mbi vlerësimin e shkallës së rrezikut ofruesi i shërbimit do të zhvillojë një vlerësim të plotë të nevojave të fëmijës. Vlerësimi i nevojave do të përfshijë nevojat sociale (duke përfshirë rrethanat	<ul style="list-style-type: none"> • Forma për vlerësimin e nevojave, ku

të cilat dërgojnë tek abuzimi) psikologjike, nevojat shëndetësore, edukativo-arsimore të fëmijës si dhe nevojat për mbështetje ligjore.	reflektohen nevojat e vlerësuara
X.2.6 Intervenimi profesional dhe mbështetja do të sigurohen sipas një Plani Individual të Kujdesit, të elaboruar në bazë të nevojave të vlerësuara. Plani individual i kujdesit do të elaborohet nga ekipi multi-disiplinor me pjesëmarrjen e fëmijës. Të gjitha vendimet dhe veprimet do tu shpjegohen dhe pajtohen me prindërit/përfaqësuesit ligjor të fëmiut, poashtu edhe me fëmiun, duke pasur parasysh moshën e tij/saj, gjendjen psikologjike dhe shëndetësore.	<ul style="list-style-type: none"> • Plani individual me të gjitha veprimet e specifikuar
X.2.7 Çdo fëmije të cilit i ofrohet mbështetje sociale do të ketë menaxherin e rastit dhe asistentin e menaxherit të rastit. Menaxheri i rastit do të koordinojë dhe monitorojë punën e ekipit multi-disiplinor.	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim në raportet e monitorimit
X.2.8 Ofruesit e shërbimit do të sigurojnë se fëmija i nënshtrohet kontrollit të detajuar mjekësor dhe se do të përcjellin gjendjen shëndetësore të fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Prezenca e dokumenteve mjekësore në dosje individuale
X.2.9 Mbështetja dhe asistenca psikologjike do të ofrohen për anëtarët e familjes së fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi në raportet e monitorimit
X.2.10 Çdo fëmije që i ofrohen shërbimet sociale do të ketë dosjen e vet individuale ku do të përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet e identifikimit • Dokumentet mjekësore • Forma e vlerësimit të nevojave me nevoja të vlerësuara Plani individual i kujdesit (i ndryshuar dhe i azhurnuar sipas nevojës)	<ul style="list-style-type: none"> • Dosja personale me dokumentet relevante
X.2.11 Fëmija mund të ndahet përkohësisht prej mjedisit të tij/ saj të natyrshëm, nëse kështu kërkojnë interesat më të mira të tij/saj. Në këto raste menaxheri i rastit, gjithmonë duke u bazuar në rekomandimet e grupit multi-disiplinor, do të identifikojë se ku duhet të referohet fëmija (familja e gjerë, familja kujdestare ose strehimorja/ kujdesi rezidencial).	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi i planeve individuale
X.2.12 Nëse fëmija është vendosur përkohësisht në strehimore/ kujdes rezidencial, procesi i menaxhimit të rastit dhe detajet e ofrimit të shërbimit do të diskutohen dhe dakordohen ndërmjet profesionistëve të cilët kanë punuar me fëmijën paraprakisht dhe specialistëve të strehimores/ institucionit rezidencial. Të gjitha aranzhimet do të bazohen në interesat më të mira të fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi i planeve individuale

X.2.13 Në strehimore/ institucion rezidencial fëmija do të prezantohet në mënyrë të përshtatshme para stafit dhe banorëve tjerë.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme
X.2.14 Në strehimore ose institucion rezidencial fëmijës do t'i sigurohet akomodimi i rehatshëm dhe kushtet për privatësi. Moshë dhe gjinia e fëmijut duhet pasur para sysh gjithmonë gjatë strehimit të tij/saj në një dhomë me të tjerët	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësira të mobiluara në mënyrë adekuate • Licenca valide
X.2.15 Çdo veprim individual apo grupor për fëmijën do të kryhet duke marrë parasysh moshën dhe gjendjen psikologjike të fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi në raportet e monitorimit
X.2.16 Menaxheri i rastit / kujdestari duhet të sigurojë kontaktet e fëmijës me anëtarët e familjes dhe të dashurit, me kusht që kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi i shkallës së rrezikut
X.2.17 Strehimoret/ institucionet rezidenciale do të plotësojnë kërkesat për standardet minimale funksionale të specifikuar për lloje përkatëse të ofrimit të shërbimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Vlerësimi në raportet e monitorimit
X.2. 18 Ofresit e shërbimit do të pajtohen me fëmijën dhe prindërit/kujdestarin ligjor për sa i përket kushteve të mbikëqyrjes pas fazës së ofrimit intensiv të shërbimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret e brendshme • Dëshmi mbi marrëveshjet